



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:222498

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05517258

P.nr.../..

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL gjyqtari i vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrje të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurit A.. P.. për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshme PP/II nr. 2088/2022 të datës 25.10.2022, jashtë seancës gjyqësore me datë 28.03.2024 bie këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr.../... e datës 23.01.2024 e lidhur në mesë të pandehurit A.. P.. dhe të dëmtuarit E.. (S..) Xh.. nga fsh. N.. K.. P..

II. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore ne Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II nr. 2088/2022 të datës 25.10.2022.

III. PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit: **A.. P..** i lindur më datë 25.04.1975, në K. Pejë, tani banon në fsh. D.. K. P., nga babai H.. dhe nëna M.. e gjinisë M., ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesëm ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. pers., posedon numër të telefonit, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

- për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK-së.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamentit të Përgjithshme me datën 25.10.2022 ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.2088/22 ndaj të pandehurit A.. P.. për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK-së.

Me datën 21.01.2024 është arrit marrëveshja në zyrën e ndërmjetësimit në mes të pandehurit A.. P.. dhe të dëmtuarit E.. (S..) Xh.. nga fsh. N.. K.. P...

Nga te cekurat me lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e pranuar marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr.212/24 e datës 23.01.2024 e lidhur në mesë të pandehurit A.. P.. dhe të dëmtuarit E.. (S..) Xh.. nga fsh. N.. K.. P...

Me dispozitën ligjore të nenin 229 par. 5 të KPRK-së është përcaktuar se: nëse aktakuza është dorëzuar, gjyqtari i vetëm gjykues, nëse e pranon formalisht marrëveshjen, merr vendim për të hedhur aktakuzën dhe e ndërprejë procedurën penale.

Andaj nga të cekurat më lartë e në kuptim 229 par.5 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM ,
DIVIZIONI PENAL
2022:222498, 28.03.2024**

Bashkëpunëtorja Profesionale

Gj y q t a r i

Edona Berisha Kastrati

Musë Povataj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit.